

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN KUKUR**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Kukur me objekt: “vlerësimin e menaxhimit financiar dhe auditit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimeve me fonde publike, taksave e tarifave vendore, administrimit të aseteve, funksionimit të policisë komunale, etj.” për periudhën 01.01.2010 - 31.12.2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 113, datë 30.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 452/7, datë 30.06.2012, dërguar z. **Luan KUKLA**, Kryetar i Komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

#### **1. Për Këshillin e Komunës Kukur.**

a. Nga Këshilli i Komunës Kukur të merret në analizë rezultatet e auditit të KLSH-së dhe të marrjes së masave të menjëhershme për realizimin e të ardhurave nga taksat vendore, pra për një menaxhim më të mirë të ardhurave nga Zyra e Tatim Taksave.

**Menjëherë**

b. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të kryhet menjëherë rivlerësimi i objekteve të komunës, si dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Gramsh, në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2002.

**Menjëherë**

#### **2. Për Prefektin e Qarkut Elbasan, Drejtorinë e Auditit.**

Të merren në analizë e të nxirren përgjegjësitë për ekipin e inspektorëve të auditit të Prefekturës së Qarkut Elbasan, sepse sipas konstatimeve të Auditit të KLSH-së, të argumentuara në Raportin e Auditimit të ushtruar në Komunën Kukur, është evidentuar gjurmë auditimi abuziv duke sjellë precedentin e fshehjes së të dhënave reale, në operacionet me risk të lartë, për proceset kryesore menaxheriale, të cilat, pasqyrohen në konkluzionet e dhëna në Raportin Përfundimtar të Auditit të Brendshëm, të Prefekturës së Qarkut Elbasan për “Kontrollin financiar në Komunën Kukur” (Kapitulli VII, faqe 5), sipas shkresës me nr. 4472/2, datë 13.11.2006.

**Menjëherë**

### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohej në rrugë ligjore, nga Komuna Kukur, shpërblimi i dëmit në vlerën totale **801,946 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe shkallët e gjykimit, ndaj shoqërisë ndërtuese [REDAKTUAR], për situacionim fiktiv dhe raportim fiktiv të punimeve të pakryera, sanksioneve ligjore të vonesave në vlerë detyrimi, në mos dorëzimin sipas afatit të kontratës, në rastin e objektit “*Ndërtim ure fshati Grazhdan*” (faza e parë).

**Menjëherë**

### **C. KALLËZIM PENAL**

Mbështetur në nenin 25 dhe 248 të ligjit 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të niset procedura ligjore për kallëzim penal për shpërdorim të detyrës shtetërore në bashkëpunim, për shtetasit e mëposhtëm:

1. **Z. ■■■**, me detyrë ish-kryetar i Komunës Kukur, njëkohësisht edhe ish-Kryetar i Entit Prokurues të Komunës.
2. **Znj. ■■■**, me detyrë mbikëqyrës i punimeve në objektin “Ndërtimi i urës në fshatin Grazhdan”.
3. **Z. ■■■**, me detyrë kolaudator i punimeve në objektin “Ndërtimi i urës në fshatin Grazhdan”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Mirosh Bogdo, Mina Blushi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**